



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

[www.legjislacionishqiptar.gov.al](http://www.legjislacionishqiptar.gov.al)

**Nr.103**

**6 gusht**

**2007**

## P Ë R M B A J T J A

Faqe

|                                |                                                                                                                                        |      |
|--------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------|
| Ligj nr.9786<br>datë 19.7.2007 | Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”..... | 2981 |
| Ligj nr.9787<br>datë 19.7.2007 | Për një shtesë në ligjin nr.7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare”, të ndryshuar.....                                          | 2982 |
| Ligj nr.9788<br>datë 19.7.2007 | Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8875, datë 4.4.2002 “Për Rojën Bregdetare Shqiptare”.....                                   | 2982 |
| Ligj nr.9789<br>datë 19.7.2007 | Për krijimin dhe funksionimin e zonave ekonomike .....                                                                                 | 2984 |
| Ligj nr.9790<br>datë 19.7.2007 | Për masat mbrojtëse në importe .....                                                                                                   | 2990 |
| Ligj nr.9791<br>datë 23.7.2007 | Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar .....                       | 3001 |

**LIGJ**  
**Nr.9786, datë 19.7.2007**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.9482, DATË 3.4.2006 “PËR  
LEGALIZIMIN, URBANIZIMIN DHE INTEGRIMIN E NDËRTIMEVE PA LEJE”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Në ligjin nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, bëhen këto ndryshime e shtesa:

**Neni 1**

Në nenin 27 fjalia e fundit ndryshohet si më poshtë:

“Për çështjet e mësipërme, subjekti kërkuar, i interesuar për legalizimin e objektit pa leje, paguan tarifën e shërbimit pranë njësisë së qeverisjes vendore ku ndodhet objekti pa leje.”.

**Neni 2**

Në nenin 32 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Shkronja “a” e pikës 1 ndryshohet si më poshtë:

“a) 20 për qind e të ardhurave në buxhetin e njësisë së qeverisjes vendore për investime vendore, në infrastrukturë e shërbime, për zonën/bllokun informal;”.

b) Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Të ardhurat e arkëtuara nga pagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë kalojnë për llogari të njësisë së qeverisjes vendore ku ndodhet objekti pa leje dhe destinohen prej saj për zhvillimin e infrastrukturës dhe urbanizimin e territoreve që legalizohen.”.

c) Pas pikës 2 shtohen pikat 3 e 4 me këtë përmbajtje:

“3. Të ardhurat e arkëtuara nga tarifa e shërbimit dhe çdo penalitet tjetër, i cili shoqëron procesin e vetëdeklarimit dhe të legalizimit, përdoren nga organet që kryejnë shërbimin për përballimin e shpenzimeve, që do të kryhen për përditësimin e zonës me ndërtime pa leje, për përgatitjen e dokumentacionit tekniko-ligjor të nevojshëm për legalizimin e objekteve dhe financimin e studimeve urbanistike të territorit me ndërtime pa leje.

4. Mënyra, koha e mbledhjes së këtyre të ardhurave, vlera e tarifës së shërbimit dhe administrimi i saj përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

**Neni 3**

Në nenin 41 fjalia e parë ndryshohet si më poshtë:

“Njësia e urbanistikës shqyrton kërkesat e paraqitura për legalizimin e shtesave dhe u njofton subjekteve, që përmbushin kriteret e dokumentacionit, të paguajnë taksën e ndikimit në infrastrukturë dhe gjobën, kur janë objekt i saj, sipas nenit 43 të këtij ligji.”.

**Neni 4**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5441, datë 31.7.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bamir Topi**

**LIGJ**  
**Nr.9787, datë 19.7.2007**

**PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR.7638, DATË 19.11.1992 “PËR SHOQËRITË TREGTARE”,  
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

**Neni 1**

Në fund të nenit 47 të ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Përjashtimisht këtij rregulli, në shoqëritë me kapital të përbashkët, për kapitalin shtetëror, që i përgjigjet pasurive të paluajtshme të shoqërisë, që i janë njohur ose kthyer ish-pronarëve, sipas legjislacionit në fuqi, ortaku shtetëror zëvendësohet nga ish-pronari në të drejtat e tij mbi pjesën takuese të këtij kapitali. Transferimi i pjesëve të kapitalit në favor të ish-pronarit, i cili zëvendëson shtetin në të drejtat e tij mbi këtë pjesë kapitali, bëhet me akt noterial, sipas procedurave të parashikuara në ligj.”.

**Neni 2**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5442, datë 31.7.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bamir Topi**

**LIGJ**  
**Nr.9788, datë 19.7.2007**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË LIGJIN NR.8875, DATË 4.4.2002 “PËR ROJËN  
BREGDETARE SHQIPTARE”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Në ligjin nr.8875, datë 4.4.2002 “Për Rojën Bregdetare Shqiptare”, bëhen këto ndryshime dhe shitesa:

**Neni 1**

Neni 3 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 3

**Varësia e Rojës Bregdetare**

1. Roja Bregdetare varet nga Ministria e Mbrojtjes. Për drejtimin e operacioneve të Rojës Bregdetare Shqiptare krijohet Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare (QNOD).

Në situata operacionale luftarake në kohë paqeje apo lufte, drejtimi e komandimi i Rojës Bregdetare Shqiptare bëhet nga autoritetet ushtarake.

2. Roja Bregdetare bashkëvepron me institucione dhe subjekte shtetërore ose private, që kanë interesa në det.

3. Mënyra e bashkëveprimit të Rojës Bregdetare me institucionet shtetërore, që kanë interesa në det, përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. Plani i zhvillimit të kapaciteteve të Rojës Bregdetare Shqiptare miratohet nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes. Plani hartohet në bashkëpunim me institucionet e përfshira në nenin 32 të ligjit nr.9251, datë 8.7.2004 "Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë".

## Neni 2

Pas nenit 4 shtohet neni 4/1 me këtë përmbajtje:

### “Neni 4/1

#### **Drejtimi operacional i Rojës Bregdetare**

1. Drejtimi operacional i Rojës Bregdetare, përveç rasteve të parashikuara në paragrafin e dytë të nenit 3 të këtij ligji, kryhet nga QNOD-ja.

2. QNOD-ja ka detyrë organizimin, planizimin dhe drejtimin e të gjitha operacioneve detare, për kontrollin e zbatimit të legjislacionit kombëtar dhe ndërkombëtar në det, kërkimin, shpëtimin dhe dhënien e ndihmës në hapësirën detare, duke përdorur, në mënyrë të integruar, të gjitha kapacitetet operacionale të disponueshme nga institucionet e përcaktuara në nenin 32 të ligjit nr.9251, datë 8.7.2004 “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”.

3. Struktura, mënyra e organizimit dhe e funksionimit të QNOD-së përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. Struktura e QNOD-së ka në përbërje personel nga të gjitha institucionet e përcaktuara në nenin 32 të ligjit nr.9251, datë 8.7.2004 “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”.

## Neni 3

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda tre muajve nga data e hyrjes në fuqi të ligjit, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji.

## Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5443, datë 31.7.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi**

## **LIGJ**

**Nr.9789, datë 19.7.2007**

### **PËR KRIJIMIN DHE FUNKSIONIMIN E ZONAVE EKONOMIKE**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

KREU I  
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1  
**Objekti i ligjit**

Ky ligj rregullon krijimin, funksionimin, mbikëqyrjen e zonave ekonomike, të drejtat dhe detyrimet e institucioneve përgjegjëse, të zhvilluesve, operatorëve, përdoruesve, që veprojnë në to, llojin e veprimtarive, që kryhen brenda tyre, si dhe mënyrën e përcaktimit të trojeve e të kufijve.

Neni 2  
**Përkufizime**

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Zonë ekonomike” është një territor, që ka një status të veçantë ekonomik, që mund të jetë zonë e lirë ose park industrial, sipas përcaktimeve të mëposhtme.
2. “Zonë e lirë” është një sipërfaqe e përcaktuar truall apo ndërtesash dhe pasurish të tjera të paluajtshme, me veprimtari prodhuese, të tregtimit dhe të shërbimeve, që vlerësohet pjesë e territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, e ndarë nga ky territor, në aspektin e regjimit fiskal dhe doganor dhe që rregullohet në përputhje me dispozitat e këtij ligji.
3. “Park industrial” është një territor i ndarë, në përputhje me një plan të përgjithshëm, i pajisur me infrastrukturën e nevojshme, si rrugë, shërbime transporti dhe publike, me ose pa ndërtesa industriale, të ngritura paraprakisht, i destinuar për zhvillim industrial.
4. “Zhvillues” është çdo person juridik, i licencuar, vendas ose i huaj, i cili ndërton, administron dhe monitoron funksionimin e zonës ekonomike, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.
5. “Operator” është çdo person juridik, vendas ose i huaj, i cili vepron brenda kufijve të zonës ekonomike, me cilësinë e menaxhuesit, nëpërmjet një marrëdhënieje kontraktuale, të lidhur ndërmjet tij dhe zhvilluesit, marrëdhënie e cila nuk është objekt i këtij ligji.
6. “Përdorues” është personi fizik ose juridik, vendas ose i huaj, i cili ushtron veprimtari ekonomike brenda zonës ekonomike, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

Neni 3  
**Krijimi i zonave ekonomike**

Krijimi i zonave ekonomike në Republikën e Shqipërisë synon të nxisë:

- a) investimet;
- b) hapjen e vendeve të reja të punës dhe rritjen e të ardhurave;
- c) përshejtimin e zhvillimit rajonal dhe zgjerimin e lidhjeve ekonomike të tregut shqiptar me atë ndërkombëtar;
- ç) futjen e teknologjisë së përparuar;
- d) shpejtimin e qarkullimit të mallrave dhe të kapitaleve.

Neni 4  
**Shpallja e zonave ekonomike**

1. Në bazë të studimeve rajonale dhe të strategjisë së zhvillimit ekonomik të vendit, ministri përgjegjës për ekonominë i paraqet Këshillit të Ministrave propozimin për krijimin e një zone ekonomike.
2. Këshilli i Ministrave miraton me vendim shpalljen e një zone ekonomike.
3. Shpallja e çdo zone ekonomike përfshin:
  - a) statusin e zonës (zonë e lirë ose park industrial);
  - b) kufijtë e zonës;
  - c) llojet e veprimtarive, që do të zhvillohen në të;
  - ç) periudhën e funksionimit të zonës;

- d) mënyrën e dhënies së zonës (qira, koncesion etj.);
- dh) procedurën e përzgjedhjes së zhvilluesit të zonës.

4. Veprimtaria ekonomike e zonës fillon pas përfundimit të ndërtimit të kufijve rrethues, të portave të hyrjes e të daljes dhe të funksionimit të pikës doganore (në rastin e një zone të lirë).

5. Përzgjedhja e zhvilluesit të zonës ekonomike bëhet sipas kriterëve të përcaktuara në ligjin nr.9663, datë 18.12.2006 "Për koncesionet".

#### Neni 5

### **Veprimtaritë e lejuara në zonat ekonomike**

Në zonat ekonomike mund të kryhet çdo lloj veprimtarie ekonomike, që nuk cenon mjedisin, florën, faunën dhe pasuritë kombëtare të Republikës së Shqipërisë dhe që nuk bie në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

## KREU II

### **ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I ZONAVE EKONOMIKE**

#### Neni 6

### **Institucioni përgjegjës**

Ministria, e cila mbulon ekonominë, është institucioni përgjegjës që ndjek të gjitha veprimtaritë për nxitjen, identifikimin, shpalljen dhe kontrollin e mirëfunksionimit të zonave ekonomike.

#### Neni 7

### **Kompetencat e institucionit përgjegjës**

Institucioni përgjegjës ka këto detyra e përgjegjësi:

1. Harton politikat dhe planet për zhvillimin e zonave ekonomike.
2. Harton rregulloren e funksionimit të zonave ekonomike, të cilën ia paraqet për shqyrtim dhe miratim Këshillit të Ministrave.
3. Identifikon zonat potenciale dhe përgatit procedurat për shpalljen e tyre.
4. Nxit dhe asiston zhvilluesit, operatorët dhe përdoruesit për krijimin, zhvillimin dhe funksionimin e zonave.
5. Pranon dhe vlerëson kërkesat për zhvillimin e zonave.
6. Licencon zhvilluesin e zonës ekonomike.
7. Ndjek zbatimin e ligjit, të rregullores, sipas pikës 2 të këtij neni, si dhe të kushteve të licencës nga zhvilluesit e zonës ekonomike.

#### Neni 8

### **Rregullorja për funksionimin e zonave ekonomike**

Këshilli i Ministrave miraton rregulloren për funksionimin e zonave ekonomike, e cila:

- a) përcakton procedurat e kontrollit të zonave ekonomike;
- b) rregullon marrëdhëniet ndërmjet institucionit përgjegjës, zhvilluesit të zonës dhe institucioneve të tjera, që ndikojnë në zhvillimin e zonës ekonomike, duke përcaktuar detyrat e secilit prej tyre;
- c) përcakton procedurat për aplikim dhe kriteret e licencimit të zhvilluesit.

## KREU III

### **MARRËDHËNIET ME ZHVILLUESIT DHE PËRDORUESIT**

#### Neni 9

### **Trualli në zonën ekonomike**

Krijimi i zonave ekonomike mund të bëhet në truall dhe në pasuri të tjera të paluajtshme, qofshin këto private ose shtetërore.

#### Neni 10

##### **Zona ekonomike në truall shtetëror**

Në rastin kur trualli ose pasuritë e tjera të paluajtshme janë pronë shtetërore:

- a) kandidati zhvillues i nënshtrohet procedurës së garës;
- b) zhvilluesi merr me koncesion truallin ose pasuritë e tjera të paluajtshme, për një periudhë kohore dhe, sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore në fuqi, gëzon të drejtën e dhënies me nënqira te përdoruesit.

#### Neni 11

##### **Zona ekonomike në truall privat**

1. Në rastin kur trualli ose pasuritë e tjera të paluajtshme janë pronë private, kandidati zhvillues paraqet pranë institucionit përgjegjës kërkesën për shpalljen e zonës ekonomike, pasi ka përcaktuar marrëdhëniet me pronarin e tyre.

2. Marrëdhëniet, që lindin ndërmjet zhvilluesit dhe pronarit të truallit ose të pasurive të tjera të paluajtshme, nuk janë objekt i këtij ligji.

#### Neni 12

##### **Legjislacioni i zbatueshëm**

Në zonat ekonomike zbatohet legjislacioni shqiptar në fuqi.

#### KREU IV

##### **PËRJASHTIMET NGA DETYRIMET FISKALE**

#### Neni 13

##### **Përrjashtimet nga detyrimet doganore**

1. Mallrat, që hyjnë në zonën e lirë nga personat e licencuar dhe shërbimet që u kryhen atyre brenda zonës së lirë, përjashtohen nga detyrimet doganore dhe tatimi mbi vlerën e shtuar.

2. Përrjashtimi nga detyrimet doganore e tatimore, sipas pikës 1 të këtij neni, fillon nga çasti i hyrjes së mallit në zonën e lirë.

3. Zonat ekonomike, me statusin e parkut industrial, nuk përrfitojnë lehtësitë e parashikuara në këtë kre.

#### Neni 14

##### **Hyrja e mallrave dhe e shërbimeve**

1. Në zonat e lira hyjnë të gjitha mallrat, pavarësisht nga natyra, cilësia, origjina, prejardhja ose vendmbërritja e tyre, përveç mallrave që ndalohen nga autoritetet përkatëse të importohen, eksportohen ose tranzitohen nëpër territorin doganor të Republikës së Shqipërisë.

2. Mallrat, që hyjnë në zonën e lirë, u nënshtrohen kontrollit doganor dhe mbikëqyrjes, në përputhje me dispozitat e Kodit Doganor dhe me rregullat për zbatimin e tij.

3. Mallrat, që sillen në zonën e lirë nga një pjesë tjetër e territorit doganor të Republikës së Shqipërisë dhe që nuk janë tranzit në zonën e lirë, përrfitojnë të gjitha lehtësitë, që përrfitojnë mallrat e eksportit.

4. Kur mallrat, që kanë hyrë në një zonë të lirë, humbasin pa një shpjegim të arsyetuar, autoriteti doganor i zonës së lirë i kërkon subjektit të licencuar të shlyejë detyrimin për këto mallra, sipas tarifave në fuqi në kohën e hyrjes në zonë dhe gjobën e detyrueshme, sipas legjislacionit në fuqi.

5. Shërbimet e infrastrukturës, që ofrohen nga pjesa tjetër e territorit doganor të Republikës së Shqipërisë për zhvilluesit dhe përdoruesit e licencuar brenda zonës së lirë, përrfitojnë të gjitha lehtësitë, që zbatohen për eksportin e shërbimeve.

Neni 15

**Dalja e mallrave dhe shërbimeve nga zona e lirë**

1. Mallrat, që dalin nga një zonë e lirë, mund të jenë:
  - a) eksporte ose rieksperte, kur dalin jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë;
  - b) hyrje në pjesën tjetër të territorit doganor të Republikës së Shqipërisë.
2. Mallrat, që hyjnë nga zona e lirë në pjesën tjetër të territorit doganor të Republikës së Shqipërisë dhe nuk janë tranzit për në një shtet tjetër:
  - a) hidhen në qarkullim të lirë në pjesën tjetër të territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, pasi të kenë paguar të gjitha detyrimet e importit. Kur këto mallra janë përftuar nga përpunimi në zonën e lirë, me përbërës nga tregu i brendshëm, vlera e këtyre përbërësve zbritet nga vlera e produkteve të përftuara, për përlogaritjen e detyrimeve doganore. Taksat dhe tatimet e tjera zbatohen për vlerën e plotë;
  - b) futen në njërën nga procedurat e tjera doganore ose lloje të tjera destinacioni doganor.
3. Origjina e mallrave, që dalin nga zona e lirë, përcaktohet në përputhje me Kodin Doganor të Republikës së Shqipërisë.

Neni 16

**Mallrat për përdorim vetjak**

Mallrat për përdorim ose konsum vetjak, që hyjnë në zonën e lirë, u nënshtrohen të gjitha detyrimeve doganore dhe tatimore.

Neni 17

**Pagesat**

Pagesat, që lidhen me veprimtarinë e personave fizikë dhe juridikë, që veprojnë brenda zonës së lirë, mund të kryhen me monedhën e vendit ose me monedhë të huaj.

KREU V

**LICENCIMI I ZONAVE EKONOMIKE**

Neni 18

**Licencimi**

Asnjë person juridik nuk mund të ndërtojë, të zhvillojë, të vërë në funksionim ose të drejtojë një zonë ekonomike pa licencën e zhvilluesit, të lëshuar nga ministri përgjegjës për ekonominë, në përputhje me procedurat e ligjit për koncesionet.

Neni 19

**Paraqitja e kërkesës për licencë**

1. Çdo person juridik mund të paraqesë kërkesën për licencë zhvilluesi, sipas procedurave të parashikuara në rregulloren e zonës ekonomike.
2. Çdo person fizik ose juridik mund të paraqesë kërkesën për të përsëritur licencën përkatëse, sipas procedurave të parashikuara në rregulloren e zonës ekonomike.

Neni 20

**Dhënia e licencës**

Ministri përgjegjës për ekonominë, në mbështetje të vendimit të Këshillit të Ministrave për shpalljen e zonës ekonomike, i jep licencën e zhvilluesit personit juridik, që ka paraqitur kërkesën dhe ka fituar garën, për të krijuar dhe vënë në funksionim zonën ekonomike. Procedurat për ndërtimin e ndërtesave në një zonë të lirë bëhen në përputhje me dispozitat e Kodit Doganor.

Neni 21

**Kushtet që i bashkëlidhen licencës**

1. Institucioni përgjegjës mund t'i bashkëlidhë licencës së zhvilluesit kushte që ai i gjykon të nevojshme, të cilat kanë qenë të njohura në procesin e konkurrimit. Kushtet specifikohen në kontratë. Ato mund të ndryshohen me kërkesën e vetë zhvilluesit, kur këto nuk bien ndesh me kriteret e konkurrimit për marrjen e kësaj licence.

2. Licenca nuk tjetërsohet pa miratimin e institucionit që e lëshon.

Neni 22

**Heqja ose ndryshimi i licencës**

1. Ministri përgjegjës për ekonominë i heq licencën zhvilluesit kur nga institucioni përgjegjës:  
a) konstatohet se ka pushuar së vepruari zona ekonomike;  
b) vërtetohet se i licencuari nuk respekton kushtet e licencës;  
c) vërtetohet se i licencuari ka kryer shkelje të këtij ligji ose të rregullores së zonës ekonomike;

ç) konstatohet se është shpallur falimentimi i të licencuarit;

d) vërtetohet se i licencuari nuk ka kryer detyrimet ndaj shtetit;

dh) konstatohet se ka mbaruar afati i licencës dhe nuk është bërë kërkesë për rinovimin e saj;

e) rezulton se ka kërkesë të të licencuarit.

2. Ministria përgjegjëse i njofton me shkrim të licencuarit arsyet e heqjes së licencës së zhvilluesit 30 ditë përpara heqjes së saj.

3. Mosmarrëveshjet, që lindin nga heqja e licencës, duhet të zgjidhen nga palët me mirëkuptim, në rast të kundërt, ato zgjidhen në rrugë gjyqësore, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 23

**Regjistri i licencave**

Institucioni përgjegjës mban një regjistër për licencat e lëshuara për zhvilluesit, ku shënohen emri i të licencuarit, biznesi ose veprimtaria e lejuar në licencë dhe kushtet që i bashkëlidhen licencës.

KREU VI

**DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT**

Neni 24

**Kontabiliteti**

1. Subjektet, që ushtrojnë veprimtari ekonomike në zonën ekonomike, mbajnë kontabilitet, në përputhje me dispozitat e ligjit nr.9228, datë 20.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, të ndryshuar, me kërkesat e doganës dhe me dispozitat për kontrollin ligjor të llogarive.

2. Ky kontabilitet vihet në dispozicion të organeve doganore dhe tatimore për të ushtruar kontroll, sa herë që këto të fundit e vlerësojnë të nevojshme.

Neni 25

**Përdorimi i të ardhurave**

Të ardhurat, që përftohen nga dhënia e licencës dhe kontratat me subjektet e zonave ekonomike, do të përdoren në përputhje me aktet nënligjore, që rregullojnë krijimin dhe administrimin e të ardhurave, që krijojnë institucionet shtetërore.

Neni 26

Ligji nr.9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, gjen zbatim edhe në zonat ekonomike.

Neni 27  
**Shfuqizimet**

Ligji nr.8636, datë 6.7.2000 “Për zonat e lira”, i ndryshuar, shfuqizohet.

Neni 28  
**Zbatimi**

Ngarkohen ministria përgjegjëse për ekonominë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij ligji.

Ngarkohet ministria përgjegjëse për ekonominë të përgatisë aktet nënligjore në zbatim të neneve 4, 7 e 8 të këtij ligji.

Neni 29  
**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5444, datë 31.7.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bamir Topi**

**LIGJ**  
**Nr.9790, datë 19.7.2007**

**PËR MASAT MBROJTËSE NË IMPORTE**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I  
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1  
**Qëllimi**

Ky ligj parashikon parimet dhe procedurat për marrjen e masave mbrojtëse, kur një produkt importohet në sasi të mëdha, duke shkaktuar dëm ose kërcënuar për dëm serioz prodhuesin vendas të produkteve të ngjashme ose të produkteve konkurruese, në mënyrë të drejtpërdrejtë, si dhe parimet e procedurat për rregullimin e këtij dëmi apo kërcënimi për dëm, me kusht që këto masa të jenë të përkohshme dhe të kufizuara, në përputhje me shkallën e dëmit apo të kërcënimit për dëm dhe me detyrimet ndërkombëtare e interesat e vendit tonë.

Neni 2  
**Përkufizime**

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) “Dëmi” është dëmi pasuror ose kërcënimi për dëm, që i shkaktohet industrisë së vendit, apo pengimi i krijimit të industrisë së vendit;

- b) “Ministria” është ministria, që mbulon fushën e tregtisë;
- c) “Hetim” është shqyrtimi për të përcaktuar ekzistencën, shkallën dhe efektin e importeve të produktit në sasi të mëdha dhe në kushte të tilla, duke shkaktuar dëm ose kërcënuar për dëm serioz prodhuesin vendas të produkteve të ngjashme ose të produkteve konkurruese, në mënyrë të drejtpërdrejtë;
- ç) “Industri shqiptare” janë prodhuesit shqiptarë të produkteve të ngjashme ose vetëm ajo pjesë e tyre, produkti i përbashkët i të cilëve përbën një pjesë të madhe të prodhimit të përgjithshëm vendas të këtyre produkteve;
- d) “Komisioni për vlerësimin e masave për importet”, që në vijim do të quhet komisioni, është organi kolegjal shtetëror, që bën shqyrtimin e masave antidumping, masave kundërbalancuese, si dhe të masave mbrojtëse për importet, në zbatim të këtij ligji;
- dh) “Masë mbrojtëse” është masa që aplikohet mbi importet e rritura, në vlerë ose sasi, për një periudhë të caktuar;
- e) “Palë të interesuara” nënkupton:
  - i) eksportuesit ose prodhuesit e huaj të produktit në hetim;
  - ii) importuesit e produktit në hetim;
  - iii) shoqatat e biznesit ose të tregtisë, pjesa më e madhe e anëtarëve të të cilave janë prodhues, eksportues ose importues të produktit në hetim;
  - iv) qeveritë e vendeve eksportuese;
  - v) prodhuesit vendas të produktit të ngjashëm;
  - vi) shoqatat e biznesit ose të tregtisë, pjesa më e madhe e anëtarëve të të cilave prodhojnë produktin e ngjashëm vendas.
- ë) “Produkt në hetim” është produkti, objekt i hetimit për masë mbrojtëse;
- f) “Produkt i ngjashëm” është produkti krejtësisht i ngjashëm me produktin në fjalë ose, në mungesë të një produkti të tillë, një produkt tjetër, që megjithëse jo krejt i njëjtë, ka karakteristika shumë të ngjashme me ato të produktit në fjalë;
- g) “Vend” është çdo shtet ose territor doganor, anëtar ose jo i Organizatës Botërore të Tregtisë.

## KREU II ORGANET E HETIMIT

### Neni 3

Ministria që mbulon tregtinë është institucioni përgjegjës për zbatimin e dispozitave të këtij ligji, për instrumentet rregulluese në tregtinë ndërkombëtare.

### Neni 4

#### **Komisioni për vlerësimin e masave për importet**

1. Për shqyrtimin e masave antidumping, masave kundërbalancuese, si dhe të masave mbrojtëse për importet, në zbatim të këtij ligji, krijohet organi kolegjal shtetëror, komisioni për vlerësimin e masave për importet.
2. Ky komision kryesohet nga ministri që mbulon çështjet e tregtisë dhe ka në përbërje shtatë anëtarë, ekspertë të institucioneve, që kanë lidhje me fushën që rregullohet nga ky ligj. Anëtarët e komisionit janë përfaqësues nga:
  - a) Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës;
  - b) Ministria e Financave;
  - c) Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit;
  - ç) Ministria e Punëve të Jashtme;
  - d) Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë;
  - dh) Drejtoria e Përgjithshme e Doganave;
  - e) Struktura që mbulon fushën, që rregullohet nga ky ligj, ministria përgjegjëse, në nivel drejtori.
3. Anëtarët e komisionit emërohen dhe shkarkohen nga Këshilli i Ministrave për një periudhë

5-vjeçare, pa të drejtë rrimërimi. Këshilli i Ministrave ka të drejtë të zëvendësojë anëtarin/anëtarët e komisionit në çdo kohë.

4. Mandati i përfaqësuesit/përfaqësuesve të ministrisë është i pakufizuar në kohë.

5. Këshilli i Ministrave, me propozimin e komisionit për vlerësimin e masave për importet, miraton rregulloren e funksionimit të këtij komisioni.

#### Neni 5

##### **Funksionet e komisionit**

1. Komisioni funksionon si një organ kolegjal e vendimmarrës, në mbështetje të ligjit nr.8480, datë 27.5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”.

2. Komisioni mbledhet sa herë kërkohet nga ministria, për të vendosur për kërkesat e bëra prej saj, të parashikuara në këtë ligj.

3. Komisioni drejtohet nga kryetari dhe, në mungesë të tij, nga anëtari me pozitën më të lartë hierarkike.

4. Këshilli i Ministrave cakton shpërblimet e anëtarëve për pjesëmarrje në komisionin për vlerësimin e masave për importet. Efektet financiare për anëtarët e komisionit përballohen nga institucionet e përfaqësuara në këtë komision.

#### Neni 6

##### **Kompetencat e komisionit**

Komisioni ka këto kompetenca:

a) miraton ose refuzon kërkesën, që bëjnë subjektet e interesuara për fillimin e hetimit, zgjatjen e periudhës së hetimit apo pezullimin e tij, në rast të tërheqjes së aplikimit gjatë hetimit;

b) kryen seanca dëgjimore me palët e interesuara, përpara marrjes së vendimit përfundimtar të hetimit;

c) vendos, në përfundim të hetimit, për marrjen ose jo të masave përfundimtare;

ç) vendos ose jo për marrjen e masave të përkohshme;

d) vendos për zgjatjen e periudhës së zbatimit të masave të përkohshme dhe të masave përfundimtare;

dh) merr vendime të tjera, në përputhje me dispozitat e këtij ligji;

e) nxjerr udhëzime, në zbatim të këtij ligji;

ë) harton rregullat e aplikimit dhe të procedurave të masave mbrojtëse;

f) zgjidh konfliktet ndërmjet subjekteve të ndryshme dhe ministrisë.

#### KREU III

##### **VLERËSIMI I DËMIT, KËRCËNIMIT PËR DËM DHE LIDHJES SHKAKËSORE**

#### Neni 7

##### **Përcaktimi dhe vlerësimi i dëmit**

Gjatë shqyrtimit të ecurisë së importeve dhe kushteve, në të cilat ato kryhen, si dhe të dëmit apo kërcënimit për dëm serioz të prodhuesve vendas, për shkak të këtyre importeve, vlerësohen këta faktorë:

a) vëllimi i importeve, veçanërisht nëse ka pësuar një rritje të madhe në terma absolutë ose relativë ndaj prodhimit apo konsumit vendas.

b) çmimi i importeve, nëse ka pasur ose jo një rënie të ndjeshme të çmimit, në terma absolutë dhe relativë, krahasuar me çmimin e një produkti të ngjashëm në Republikën e Shqipërisë.

c) ndikimi i importeve të prodhuesit vendas, që prodhojnë produkte të ngjashme ose konkurruese, në mënyrë të drejtpërdrejtë, siç tregohet nëpërmjet disa faktorëve ekonomikë si: prodhimi, produktiviteti, shfrytëzimi i kapacitetit, gjendjet, shitjet, pjesa e tregut, çmimet, fitim/humbjet, kthimi i kapitalit të vet, fluksi i arkës dhe niveli i punësimit.

ç) faktorët e tjerë, që po shkaktojnë ose i kanë shkaktuar dëm industrisë vendase.

## Neni 8

### **Përcaktimi dhe vlerësimi i kërcënimit për dëm**

Kur pretendohet për një kërcënim për dëm serioz, ministria shqyrton edhe mundësinë e kalimit nga kërcënim për dëm në një dëm të vërtetë. Në raste të tilla, përveç faktorëve të përcaktuar në nenin 7 të këtij ligji, vlerësohen edhe këta faktorë:

- a) norma e rritjes së eksporteve për në Republikën e Shqipërisë;
- b) kapaciteti i eksportit në vendin e eksportit dhe/ose të origjinës, siç është ose siç mund të parashikohet të ndodhë në një të ardhme të afërt dhe mundësia që ky kapacitet të përdoret për eksport për në Republikën e Shqipërisë.

## Neni 9

### **Lidhja shkakësore**

1. Komisioni, pas shqyrtimit të të dhënave përkatëse për faktorët e përcaktuar në nenet 7 e 8 të këtij ligji, vërteton se ndërmjet importeve të rritura e kushteve, në të cilat ato kryhen dhe dëmit apo kërcënimit për dëm serioz të prodhuesve vendas, ka një lidhje shkakësore.

2. Komisioni, përveç importeve të rritura, shqyrton edhe faktorët e tjerë, të cilët, në të njëjtën kohë, dëmtojnë industrinë shqiptare dhe dëmet e shkaktuara prej tyre nuk duhet t'u atribuohen importeve të rritura.

Ndër faktorët e tjerë, që mund të ndikojnë në dëm apo kërcënim për dëm, janë:

- a) vëllimi dhe çmimet e eksportit në sasi normale të një produkti të veçantë;
- b) ulja e kërkesës për produktin ose ndryshimet e modeleve të konsumit;
- c) praktikat, që kufizojnë tregtinë dhe konkurrencën ndërmjet prodhuesve vendas dhe të huaj;
- ç) zhvillimet teknologjike;
- d) eksportet e realizuara dhe produktiviteti i industrisë vendase.

## KREU IV

### **PROCESI I HETIMIT**

## Neni 10

### **Kushtet për aplikim dhe plotësimi i formularëve**

1. Procedura për aplikim për fillimin e hetimit për vendosjen e masave mbrojtëse fillon pas paraqitjes me shkrim të kërkesës nga/ose në emër të prodhuesve shqiptarë, që përbëjnë pjesën dominuese të industrisë vendase, kur pretendohet se një produkt është importuar në sasi të mëdha dhe në kushte të tilla, duke i shkaktuar dëm apo kërcënim për dëm serioz prodhuesve vendas, që prodhojnë produkte të ngjashme ose produkte konkurruese, në mënyrë të drejtpërdrejtë.

2. Aplikimi vlerësohet të jetë bërë nga/ose në emër të industrisë vendase vetëm nëse:

a) mbështetet nga ata prodhues shqiptarë, prodhimi i përbashkët i të cilëve përbën më shumë se 50 për qind të prodhimit total të produktit të ngjashëm, pavarësisht nëse shprehen pro ose kundër aplikimit;

b) prodhuesit shqiptarë, që shprehen pro aplikimit, përbëjnë jo më pak se 25 për qind të prodhimit total të produktit të ngjashëm të industrisë shqiptare.

3. Në raste të veçanta, ministria fillon procesin e hetimit, me nismën e vet dhe me miratimin e komisionit, edhe kur nuk merr një aplikim me shkrim nga/ose në emër të industrisë vendase.

4. Për aplikimet përdoren formularë, të cilat miratohen nga komisioni e që sigurohen pranë ministrisë dhe përmbajnë të dhënat e mëposhtme:

- a) emrin, vendbanimin dhe adresën e aplikantit ose të përfaqësuesit të tij të autorizuar;
- b) veprimtarinë kryesore;
- c) vëllimin dhe vlerën e prodhimit vendas për produktin e ngjashëm ose konkurrues, në mënyrë të drejtpërdrejtë, ndaj produktit të importuar;
- ç) përshkrimin në terma të vëllimit dhe vlerës së importit, të pjesës së tregut të prodhimit të aplikantit ndaj prodhimit total shqiptar;
- d) përshkrimin e produktit të importuar, specifikime për cilësinë e tij krahasuar me produktin

me origjinë shqiptare dhe hollësi për karakteristikat e tjera dalluese, vëllimin dhe vlerën e importuar, sipas njësive të përshtatur dhe klasifikimin tarifor;

dh) vendin e origjinës së produktit dhe të dhëna për eksportuesin dhe/ose për importuesin;

e) pozicionin konkurrues të produktit të ngjashëm, të prodhuar nga prodhuesit shqiptarë, në tregun vendas;

ë) fakte për ekzistencën e dëmit apo kërcënimit për dëm për 3 vitet e fundit, duke paraqitur të dhëna për prodhimin vendas, produktivitetin, shfrytëzimin e kapacitetit, gjendjet, shitjet, pjesën e tregut, çmimet etj. për këtë periudhë;

f) faktet që tregojnë se shkak i vetëm ose kryesor i dëmit apo kërcënimit për dëm të prodhimit shqiptar të produktit të ngjashëm ose konkurrues, në mënyrë të drejtpërdrejtë, është rritja e ndjeshme e importeve;

g) arsyet pse aplikimi i një mase mbrojtëse, në rastin konkret, është në interes të Republikës së Shqipërisë;

gj) programin për përshtatje të industrisë vendase ndaj konkurrencës së importeve, në rastet e aplikimit të një mase mbrojtëse.

Ministria, kur e gjykon të nevojshme, kërkon të dhëna dhe dokumente shtesë në çdo fazë të procedurës për fillimin e hetimit.

5. Çdo aplikim, sipas dispozitave të këtij neni, mund të tërhiqet përpara fillimit të hetimit dhe, në këtë rast, vlerësohet sikur të mos jetë bërë.

#### Neni 11

#### **Mbikëqyrja**

1. Një produkt i importuar bëhet objekt i mbikëqyrjes paraprake, në përputhje me pikat e këtij neni, kur:

a) ecuria e importeve të një produkti me origjinë nga një vend i tretë, kërcënon t'u shkaktojë dëm prodhuesve shqiptarë të produktit të ngjashëm;

b) është paraqitur një kërkesë me shkrim për aplikim, sipas kushteve të përcaktuara në nenin 10 të këtij ligji;

c) kjo gjë nuk bie ndesh me interesat e Republikës së Shqipërisë.

2. Komisioni, me kërkesë të ministrit, vendos për marrjen e masës së mbikëqyrjes, për një periudhë të caktuar kohore, jo më shumë se 9 muaj.

3. Produktet, objekt mbikëqyrjeje paraprake, dalin në qarkullim të lirë vetëm kur shoqërohen me një dokument importi. Ky dokument nënshkruhet nga komisioni, pa pagesë, për çdo sasi të kërkuar, brenda një afati kohor 5 ditë pune nga marrja e deklaratës së një importuesi, pavarësisht nga vendi ku ai zhvillon veprimtarinë.

4. Dokumenti i importit dhe deklarata e importuesit bëhen sipas formës së paraqitur në model. Dokumenti i importit për mbikëqyrjen përmban këto të dhëna:

a) emrin, adresën e plotë të aplikantit;

b) numrin e regjistrimit;

c) emrin dhe adresën e deklaruesit;

ç) adresën e komisionit;

d) datën e fundit të vlefshmërisë;

dh) vendin e origjinës së mallit;

e) datën e importimit;

ë) përshkrimin e produktit, etiketat dhe numrat, numrin dhe tipin e paketimit;

f) kodin e produktit;

g) peshën bruto dhe peshën neto të produktit dhe të njësive të tjera shtesë;

gj) të dhënat plotësuese;

h) deklaratën e importuesit për saktësinë e të dhënave në aplikim;

i) vulën e komisionit.

Kopja origjinale e dokumentit të importit i jepet aplikantit dhe një kopje e saj mbahet nga komisioni.

5. Produktet vazhdojnë të dalin në qarkullim të lirë për aq kohë sa çmimi për njësi i produktit, me të cilin është bërë transaksioni, e kalon atë të treguar në dokumentin e importit për më pak se 5 për

qind, ose vlera totale e sasisë së produkteve të paraqitura për import e kalon vlerën ose sasinë e dhënë në dokumentin e importit prej më pak se 5 për qind. Komisioni, duke marrë parasysh natyrën e produkteve dhe karakteristikat e tjera të veçanta të transaksioneve në fjalë, me kërkesë të palës së interesuar, vendos një përqindje tjetër të ndryshme, e cila nuk duhet t'i kalojë 10 për qind.

6. Dokumenti i importit përdoret për aq kohë sa në fuqi janë masat për mbikëqyrjen e produkteve të importuara. Ky dokument importi, në asnjë rast, nuk mund të përdoret pas mbarimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 2 të nenit 11 të këtij ligji.

7. Pas marrjes së vendimit, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, origjina e produktit, objekt i mbikëqyrjes, provohet me një certifikatë origjine.

#### Neni 12

##### **Vendimi për fillimin e hetimit**

1. Vendimi për fillimin e hetimit merret nga komisioni. Ministria, pasi shqyrton saktësinë dhe mjaftueshmërinë e të dhënave të paraqitura në aplikim dhe të informacionit shtesë të kërkuar, ia paraqet ato komisionit për vlerësim. Gjatë këtij vlerësimi, komisioni duhet të mbajë parasysh:

a) nivelin e kushtet e importeve, ecurinë e importit të produktit në fjalë dhe faktorët e lidhur me kushtet ekonomike të prodhuesve vendas;

b) masat që mund të merren sipas dispozitave të këtij ligji.

2. Ministria i kërkon komisionit të vendosë për fillimin ose jo të një hetimi për masa mbrojtëse, brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes me shkrim të aplikimit të shkruar. Kur aplikimi përfshin çështje komplekse ose kur ministria ka kërkuar informacion shtesë nga aplikuesi, ky afat shtyhet deri në 45 ditë.

#### Neni 13

##### **Njoftimi për fillimin e hetimit**

1. Kur komisioni vendos për fillimin e një procedure hetimi, atëherë ministria:

a) njofton për fillimin e hetimit shtetet, produktet e të cilave janë objekt i hetimit dhe palët e interesuara që kanë interesa, si eksportuesit, importuesit dhe shoqatat përfaqësuese të interesuara të importuesve ose eksportuesve, si dhe vendin e origjinës dhe/ose eksportuesit e paditësit;

b) bën një njoftim publik në Fletoren Zyrtare dhe në një gazetë me qarkullim të madh në Republikën e Shqipërisë.

2. Njoftimi publik dhe njoftimet e tjera përmbajnë të dhënat e mëposhtme:

a) deklarin e fillimit të procedurës së hetimit;

b) emrin e vendit ose të vendeve eksportuese, ose nëse nuk është vendi në fjalë, emrin e vendit apo të vendeve të origjinës së produktit që hetohet;

c) përshkrimin e produktit që hetohet, përfshirë karakteristikat teknike të tij, përdorimin dhe numrin aktual të klasifikimit;

ç) përmbledhjen e faktorëve, në të cilat bazohet pretendimi i dëmit;

d) adresën ku duhet të drejtohen përfaqësitë e palëve të interesuara;

dh) datën e fillimit të hetimit;

e) përcaktimin e afatit kohor për palët e interesuara, gjatë të cilit ato mund të deklarojnë interesat e tyre për pjesëmarrje në procedurën e hetimit, duke dhënë të dhëna me shkrim, të cilat të merren parasysh gjatë hetimit. Ky afat nuk duhet të jetë më shumë se 30 ditë, duke filluar nga data e botimit të vendimit në Fletoren Zyrtare. Hetimi fillon në ditën që bëhet njoftimi publik.

3. Kur komisioni vendos të mos fillojë hetimin, vendimi i tij u njoftohet me shkrim brenda 1 muaji aplikuesve nëpërmjet ministrisë.

#### Neni 14

##### **Hetimi**

1. Palët e interesuara dëgjojnë nga ministria, në rast se ato kanë bërë kërkesë me shkrim, brenda periudhës së parashikuar në njoftimin publik, duke argumentuar se mund të dëmtohen nga përfundimet e hetimit dhe kanë arsye të veçanta për t'u dëgjuar.

2. Ministria dëgjon palët e interesuara, individualisht ose së bashku. Informacioni gojor i dhënë nga palët e interesuara merret në konsideratë nga ministria, me kusht që ky informacion të jetë paraqitur me shkrim. Palët e interesuara, të cilat janë vënë në dijeni në periudhën e caktuar në njoftimin publik, kanë të drejtë që, nëpërmjet një kërkesë me shkrim, të shqyrtojnë të dhënat e disponueshme për zhvillimin e hetimit, në përputhje me parimin e ruajtjes së konfidencialitetit të të dhënave.

3. Kur informacioni nuk është dhënë brenda kufijve kohorë, të caktuar nga ministria, ose hetimi është penguar, atëherë ministria nxjerr përfundime në bazë të fakteve që disponohen. Kur ministria zbulon se palët e interesuara kanë dhënë informacion të rremë ose mashtrues, atëherë ky informacion nuk merret parasysh.

4. Në rast se aplikimi tërhiqet gjatë procesit të hetimit, komisioni shqyrton situatën dhe vendos për mbylljen e hetimit, përveç rastit kur vazhdimi i hetimit është në interes të Republikës së Shqipërisë.

5. Hetimi kryhet nga ministria dhe duhet të përfundojë brenda 180 ditëve. Në raste të veçanta, kjo periudhë mund të zgjatet edhe për 60 ditë të tjera dhe bëhet një njoftim në Fletoren Zyrtare.

#### Neni 15

#### **Mbledhja e të dhënave**

1. Me fillimin e hetimeve, komisioni, nëpërmjet ministrisë, i dërgon pyetësorë çdo personi, që beson se mund të ketë të dhëna të vlefshme për hetimin, duke përfshirë prodhues të njohur vendas, importues, eksportues, prodhues të huaj dhe qeveri të vendeve, produktet e të cilave janë objekt hetimi.

2. Komisioni cakton një afat kohor 30-ditor, brenda të cilit eksportuesit, prodhuesit e huaj dhe vendet e interesuara, që kanë marrë pyetësorët, të japin përgjigje. Ky afat kohor llogaritet nga dita kur pyetësori i është dërguar marrësit ose i është transmetuar përfaqësisë diplomatike të vendit eksportues. Komisioni merr parasysh kërkesat për zgjatjen edhe 15 ditë të këtij afati dhe miraton këtë zgjatje, në bazë të arsyeve të justifikuara. Pyetësorët shkruhen në shqip dhe anglisht.

3. Gjatë hetimit, komisioni, nëpërmjet ministrisë, mund të kërkojë nga palët e interesuara të dhëna shtesë, në formën e pyetësorëve ose të kërkesave të shkruara, sqarime ose të dhëna të mëtejshme. Afati i dorëzimit të kërkesave shtesë është i njëjtë me atë të parashikuar në pikën 2 të këtij neni.

4. Ministria kryen inspektive verifikuese, për të vërtetuar të dhënat e paraqitura nga palët e interesuara. Palët njoftohen për të dhënat që do të verifikohen, por kjo nuk pengon bërjen e kërkesave për hollësi të mëtejshme, për qartësimin e të dhënave të siguruara.

5. Komisioni jep vlerësimet e veta për ekzistencën e importeve të rritura, të dëmit apo lidhjes shkakësore, në bazë të të dhënave për periudhën, për të cilën janë kërkuar këto të dhëna.

#### Neni 16

#### **Seancat dëgjimore**

1. Me kërkesën me shkrim të çdo pale të interesuar, komisioni planifikon një seancë dëgjimore, ku të gjitha palët e interesuara paraqesin të dhëna dhe argumente. Seancat dëgjimore bëhen jo më vonë se 30 ditë përpara datës së propozuar për marrjen e vendimit përfundimtar.

Sipas kërkesës, komisioni u krijon palëve të interesuara mundësinë për t'u takuar, ku të mund të shprehin pikëpamjet dhe argumentet e kundërta, por pjesëmarrja në takim nuk përbën detyrim për asnjërën nga palët dhe mospjesëmarrja nuk sjell paragjykim për asnjërën nga palët.

2. Palët e interesuara, që duan të marrin pjesë në seancat dëgjimore, duhet të dërgojnë me shkrim në komision emrat e përfaqësuesve dhe të dëshmitarëve të tyre, të paktën 7 ditë para datës së zhvillimit të seancës.

3. Palët e interesuara, gjatë takimeve me anëtarët e komisionit, kanë të drejtë të paraqesin me gojë edhe të dhëna të tjera. Komisioni duhet të përcaktojë, me vendim, një kohë të barabartë për secilën palë dhe duhet ta vendosë në dosjen publike vendimin e marrë dhe të dhënat e paraqitura nga palët, duke përjashtuar informacionin konfidencial.

Neni 17

**Përfundimi i hetimit**

1. Në fund të hetimit, ministria i paraqet komisionit një raport për rezultatet e hetimit, ku parashtron edhe propozimet e veta.

2. Komisioni, të paktën 30 ditë para marrjes së vendimit përfundimtar, njofton me shkrim të gjitha palët e interesuara, në përputhje me parimin e ruajtjes së informacionit konfidencial për faktet themelore në shqyrtim, që përbëjnë bazat për vendimin ose për vendosjen e masave të përkohshme apo përfundimtare.

3. Në mbarim të hetimit merret një vendim përfundimtar, për të cilin komisioni bën njoftim publik. Në njoftim duhet të përfshihen të gjitha të dhënat përkatëse për faktet dhe arsyet, që çuan në marrjen e këtij vendimi, në përputhje me parimin e ruajtjes së informacionit konfidencial dhe në veçanti:

- a) emrat e eksportuesve dhe të prodhuesve të njohur të produktit në hetim;
- b) përshkrimi i plotë i produktit në hetim, i nevojshëm për qëllime doganore (taksave doganore), përfshirë klasifikimin tarifor aktual shqiptar;
- c) sasi të importeve të rritura;
- ç) faktorët, që çuan në përcaktimin e dëmit dhe të lidhjes shkakësore, përfshirë edhe të dhënat për këta faktorë, përveç importeve të rritura, që janë marrë parasysh;
- d) çdo arsye tjetër, që ka çuar në vendimin përfundimtar;
- dh) arsyet për pranim ose refuzim të argumenteve apo padive përkatëse, të bëra nga eksportuesit dhe importuesit;
- e) masat mbrojtëse, të përcaktuara për t'u vendosur, si dhe çdo masë në interes të Republikës së Shqipërisë.

4. Njoftimi botohet në Fletoren Zyrtare dhe në një gazetë me qarkullim të madh në Republikën e Shqipërisë dhe i dërgohet edhe vendit, produktet e të cilit janë objekt i këtij përcaktimi, si dhe palëve të tjera, që janë të interesuara.

KREU V

**VENDOSJA DHE ZBATIMI I MASAVE MBROJTËSE**

Neni 18

**Masat mbrojtëse të përkohshme**

1. Masat mbrojtëse të përkohshme zbatohen kur:

a) në rrethana kritike, mosvendosja e tyre shkakton dëm, për të cilin riparimi do të ishte shumë i vështirë;

b) në bazë të të dhënave paraprake të qarta, vërtetohet se importet në rritje kanë shkaktuar ose kërcënojnë t'u shkaktojnë një dëm serioz prodhuesve vendas, që prodhojnë produkte të ngjashme ose produkte konkurruese, në mënyrë të drejtpërdrejtë.

2. Masat mbrojtëse të përkohshme marrin formën e një rritjeje tarifore. Në rast shfuqizimi të masës mbrojtëse të përkohshme, për arsye të mosvërtetimit, gjatë hetimit të dëmit apo kërcënimit për dëm, të shkaktuar industrisë vendase nga importet e rritura, kjo rritje tarifore e mbledhur i rikthehet menjëherë pagesit.

3. Afati i një mase mbrojtëse të përkohshme nuk duhet t'i kalojë 200 ditë. Kohëzgjatja e një mase mbrojtëse të përkohshme llogaritet si pjesë e periudhës totale të zbatimit të masave mbrojtëse.

Neni 19

**Masat mbrojtëse përfundimtare**

1. Masat mbrojtëse përfundimtare zbatohen në përfundim të hetimit, në përputhje me interesat e vendit, kur një produkt është importuar në sasi kaq të mëdha dhe në kushte të tilla, sa që i shkakton ose kërcënon t'u shkaktojë dëm serioz prodhuesve vendas, që prodhojnë produkte të ngjashme ose produkte konkurruese, në mënyrë të drejtpërdrejtë. Kur vendoset marrja e një mase mbrojtëse përfundimtare, merren parasysh:

- a) kostot ekonomike dhe sociale, afatshkurtra dhe afatmesme, si pasojë e zbatimit të masës;
- b) kostoja e moszbatimit të masës;
- c) ndikimi i masës mbrojtëse te konsumatorët dhe në konkurrencën në tregun vendas.

2. Masa mbrojtëse përfundimtare zbatohet për kohën e nevojshme për të parandaluar ose rregulluar dëmin e shkaktuar industrisë shqiptare dhe për t'i lehtësuar asaj përshtatjen me tregun. Masat mbrojtëse marrin formën e:

- a) vlerës doganore shtesë.

Kur masat mbrojtëse përfundimtare marrin formën e një vlere doganore shtesë, diferenca ndërmjet taksës doganore, të vendosur me regjim importi dhe vlerës doganore shtesë, të vendosur si masë mbrojtëse përfundimtare, mblidhet si siguri, në përputhje me dispozitat e Kodit Doganor. Edhe kur nuk ka taksë doganore, të vendosur me regjim importi, e gjithë vlera doganore shtesë, e vendosur si masë mbrojtëse përfundimtare, mblidhet si siguri, në përputhje me dispozitat e Kodit Doganor;

- b) kufizimeve sasiore të importeve.

Në rastet e vendosjes së një kufizimi sasior mbi importet, si një masë mbrojtëse, merren parasysh, veçanërisht:

- i) flukset tradicionale të tregtisë;
- ii) vëllimi i produkteve të eksportuara në Republikën e Shqipërisë, sipas kontratave të përfunduara para hyrjes në fuqi të masës mbrojtëse;
- iii) ndikimi i anës negative të vendosjes së një kufizimi sasior mbi importet;
- iv) regjimi, sipas së cilit për importimin e një produkti të caktuar në Republikën e Shqipërisë, kërkohet një dokument importi, i lëshuar sipas termave dhe kushteve të përcaktuara nga komisioni.

3. Kufizimet sasiore, të parashikuara në shkronjën "b" të pikës 2 të këtij neni, nuk mund të jenë më të ulëta se niveli mesatar i importeve në tri vitet e fundit, për të cilat ka statistika, për sa kohë që nuk është i nevojshëm një nivel tjetër, për të parandaluar apo rregulluar dëmin serioz, që i është shkaktuar industrisë shqiptare.

4. Kur shumica e masës mbrojtëse përfundimtare është më e vogël se shumica e masës mbrojtëse të përkohshme, diferenca kthehet, ndërsa kur shumica e masës mbrojtëse përfundimtare është më e madhe se shumica e masës mbrojtëse të përkohshme, diferenca mblidhet.

5. Nëse komisioni vendos se nuk është i nevojshëm zbatimi i masave mbrojtëse përfundimtare, masa mbrojtëse e përkohshme shfuqizohet dhe shumica e mbledhur më parë, si rezultat i masave mbrojtëse të përkohshme, kthehet në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi për kthimin e taksave doganore.

6. Për zbatimin e një mase mbrojtëse përcaktohen:

- a) lloji i masës mbrojtëse;
- b) produkti, objekt i masës dhe kodi i tij tarifor;
- c) periudha fillestare e zbatimit të masës mbrojtëse;
- ç) skema për liberalizimin progresiv të masës;
- d) kushtet për zbatimin e masës mbrojtëse;
- dh) baza për zbatimin e masës mbrojtëse;
- e) zbatimi i masës mbrojtëse për importet nga vendet, të cilat janë palë në marrëveshjet e tregtisë së lirë me Republikën e Shqipërisë, ku parashikohen terma dhe kushte të veçanta për zbatimin e masave mbrojtëse.

## Neni 20

### Zgjatja dhe rishikimi i masave mbrojtëse

1. Kohëzgjatja e zbatimit të masave mbrojtëse nuk duhet të jetë më shumë se 4 vjet, përfshirë edhe kohëzgjatjen e ndonjë mase të përkohshme.

2. Periudha e përmendur në pikën 2 të këtij neni zgjatet me kusht që:

- a) masa mbrojtëse të vazhdojë të jetë e nevojshme për parandalimin apo rregullimin e dëmit;
- b) të ketë të dhëna se prodhuesit vendas po përshtaten me kushtet e tregut të brendshëm.

3. Masa mbrojtëse, për të cilën zgjatet periudha e zbatimit:

- a) nuk mund të jetë më kufizuese siç ishte në fund të periudhës fillestare;
- b) vazhdon të liberalizohet progresivisht.

4. Periudha e plotë e zbatimit të një mase mbrojtëse, që përfshin periudhën e zbatimit të masës mbrojtëse të përkohshme, periudhën e zbatimit të masës mbrojtëse, si dhe periudhën e zgjatjes së zbatimit të masës, nuk duhet të jetë më shumë se 8 vjet.

5. Kur kohëzgjatja e zbatimit të një mase kalon një vit, masa liberalizohet progresivisht, me intervale të vazhdueshme, gjatë periudhës së zbatimit, ndërsa kur kalon 3 vjet, atëherë do të rishikohet situata jo më vonë se gjysma e kohëzgjatjes së zbatimit të masës, në mënyrë që të përcaktohet nëse është ende i nevojshëm zbatimi i saj apo rritja e ritmit të liberalizimit.

6. Ministria, me nismën e vet ose me anë të një kërkesë të bërë nga çdo palë ose çdo i interesuar, thërret, gjatë periudhës së zbatimit të një mase mbrojtëse, komisionin, për të shqyrtuar efektet e kësaj mase dhe për të vlerësuar nëse është ende i nevojshëm zbatimi i saj. Komisioni merr vendim për të proceduar për zbatimin e masës apo për ta tërhequr atë. Vendimet e marra nga komisioni, përfshirë edhe përmbledhjen e arsyeve, botohen në Fletoren Zyrtare.

7. Asnjë masë mbrojtëse përfundimtare nuk zbatohet përsëri ndaj importit të një produkti, i cili ka qenë objekt i një mase të tillë për një periudhë kohe, të barabartë me gjysmën e periudhës, gjatë së cilës një masë e tillë është zbatuar më parë, me kusht që periudha e moszbatimit të jetë të paktën 2 vjet.

8. Masa mbrojtëse, për të cilën është përcaktuar një kohëzgjatje 180-ditore apo më pak, mund të zbatohet përsëri ndaj një produkti të importuar, në rastet kur:

a) ka kaluar të paktën 1 vit nga data e njoftimit të një mase mbrojtëse ndaj importit të këtij produkti;

b) një masë e tillë nuk është zbatuar më shumë se dy herë mbi të njëjtin produkt, brenda një periudhe 5- vjeçare, para datës së njoftimit të masës.

9. Masa mbrojtëse nuk zbatohet ndaj importit të një produkti me origjinë nga një vend anëtar i OBT-së, nëse:

a) pjesa e importeve të produktit nga ky vend në Republikën e Shqipërisë nuk i kalon 3 për qind të të gjitha importeve të këtij produkti;

b) pjesa e importeve me më pak se 3 për qind nga vendet anëtare, së bashku, të përbëjnë jo më shumë se 9 për qind të importeve totale të produktit në Republikën e Shqipërisë.

## Neni 21

### Konfidencialiteti

1. Të dhënat e marra përdoren vetëm për arsyet, për të cilat ato janë kërkuar.

2. Asnjë e dhënë e një natyre konfidenciale ose e siguruar në baza konfidencialiteti nuk bëhet e ditur pa lejen me shkrim të subjektit, burim i kësaj të dhëne.

3. Të dhënat trajtohen konfidenciale kur:

a) bërja publike e tyre ka efekte të pafavorshme për personin që i jep, ose për personin nga i cili janë marrë këto të dhëna;

b) palët kanë argumentuar se i kanë siguruar në bazë konfidencialiteti.

4. Palët e interesuara, që kanë siguruar të dhënat konfidenciale, duhet të japin një përmbledhje me hollësi për këto të dhëna, pa cenuar konfidencialitetin, të mjaftueshme për të kuptuar thelbin e informacionit të dhënë si konfidencial. Për raste të veçanta, palët mund të shpjegojnë se për të tilla informacione nuk mund të paraqitet përmbledhje, duke dhënë edhe arsyet me shkrim.

5. Të dhënat nuk trajtohen konfidenciale kur:

a) një kërkesë për konfidencialitet nuk është e justifikuar;

b) edhe pse dhënësi nuk autorizon zbulimin e të dhënave, në çfarëdo forme, ato verifikohen nga burime të tjera të besueshme.

6. Dispozitat e mësipërme nuk pengojnë komisionin t'i përdorë të dhënat e përmendura në pikat e mësipërme të këtij neni, si referencë për informacionin e përgjithshëm dhe, në veçanti, për të arsyetuar vendimet e marra, sipas këtij ligji.

## Neni 22

### Dosja publike dhe e drejta e informimit prej saj

Ministria, për çdo hetim ose rishikim, krijon, në përputhje me kërkesën për ruajtjen e

informacionit konfidencial, një dosje, e cila, herë pas here, plotësohet me:

- a) të gjitha raportet publike për hetimin ose rishikimin;
- b) të gjitha materialet, përfshirë pyetësorët, përgjigjet e pyetësorëve dhe lajmërimet e shkruara, që i janë paraqitur komisionit;
- c) të gjitha të dhënat e tjera, të formuluar ose të marra nga komisioni, përfshirë edhe ndonjë raport verifikimi të kryer;
- ç) të gjitha dokumentet e tjera, të vlerësuara të përshtatshme për lajmërim publik.

Dosja u vihet në dispozicion palëve të interesuara, në çdo fazë, si gjatë hetimit, rishikimit edhe gjatë proceseve gjyqësore.

## KREU VI RISHIKIMI GJYQËSOR

### Neni 23 **Rishikimi gjyqësor**

Çdo palë e interesuar, që ka marrë pjesë në një procedurë hetimi, rishikimi ose kthimi parash, të kryer nga komisioni, në çdo kohë, mund të kërkojë rishikim të menjëhershëm për vendimet përfundimtare, të marra nga komisioni dhe ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës.

## KREU VII DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

### Neni 24 **Detyrime ndërkombëtare**

Ky ligj zbatohet në përputhje me detyrimet ndërkombëtare, që ka Republika e Shqipërisë si anëtare e OBT-së, me “Marrëveshjen e përgjithshme për tarifatat dhe tregtinë, 1994” (GATT, 1994) dhe me nenin 19 të GATT-it, 1994 “Marrëveshja për masat mbrojtëse”.

### Neni 25 **Dispozita përjashtuese**

Ky ligj nuk pengon zbatimin e:

- a) ndalimeve, kufizimeve apo kontrolleve sasiore për importet, në mbështetje të legjislacionit në fuqi në mbrojtje të rregullit dhe të sigurisë publike, në mbrojtje të shëndetit dhe të jetës së njerëzve, kafshëve dhe bimëve, në mbrojtje të pasurisë kombëtare, me vlera artistike, historike dhe arkeologjike, ose në mbrojtje të pronësisë, industriale dhe tregtare;
- b) veprimeve për këmbimin e monedhës së huaj;
- c) detyrimeve, që rrjedhin nga marrëveshjet ndërkombëtare;
- ç) akteve ligjore dhe nënligjore për importet, si dhe të ligjeve të tjera për importet, kur nuk bien ndesh me këtë ligj.

### Neni 26 **Dispozita të fundit dhe kalimtare**

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, me hyrjen në fuqi të këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 4 pikat 3 e 5 dhe 5 pika 4.

### Neni 27 **Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5445, datë 31.7.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bamir Topi**

**LIGJ**  
**Nr.9791, datë 23.7.2007**

**PËR DISA SHTESA E NDRYSHIME NË LIGJIN NR.9385, DATË 4.5.2005 “PËR PYJET DHE SHËRBIMIN PYJOR”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Në ligjin nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa e ndryshime:

**Neni 1**

Në nenin 2 bëhen shtesat si më poshtë:

1. Në fund të pikës 21 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Për zbatimin e Protokollit të Kiotos pyll vlerësohet edhe sipërfaqja e tokës me një grup të dendur drurësh pyjorë, me sipërfaqe më të madhe se 0,1 ha, me shkallë mbulimi jo më të vogël se 30 për qind dhe me potencial për të arritur lartësi më të madhe se 3 metra, kur pylli ka arritur maturinë në kushte in-situ.”.

2. Pas pikës 30 shtohen pikat 31, 32 e 33 me këtë përmbajtje:

“31. “Ministria” është ministria përgjegjëse për pyjet.

32. “Ministër” është ministri përgjegjës për pyjet.

33. “Pyll komunal” është pylli në pronësi apo në përdorim të organeve të qeverisjes vendore.”.

**Neni 2**

Në nenin 5 bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

1. Pika 4 ndryshohet si më poshtë:

“4. Plani i mbarështimit të pyjeve shtetërore shqyrtohet nga komisioni teknik pranë Drejtorisë së Politikave Pyjore, i ngritur me urdhër të ministrit. Plani miratohet nga ministri.”.

2. Pas pikës 4 shtohen pikat 5 e 6 me këtë përmbajtje:

“5. Planet e mbarështimit të pyjeve komunale dhe private hartohen nga subjekte të licencuara dhe miratohen, sipas rastit, nga këshilli i komunës/bashkisë, në bashkëpunim me drejtorinë përkatëse të shërbimit pyjor.

6. Mënyra e hartimit të planeve të mbarështimit të pyjeve, e cila zbatohet për të gjitha format e pronësisë së pyllit, caktohet me udhëzim të ministrit.”.

**Neni 3**

Në nenin 7 bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

1. Shkronja “b” e pikës 2 ndryshohet si më poshtë:

“b) drejtoritë rajonale të shërbimit pyjor;”.

2. Pas shkronjës “b” shtohet shkronja “c” me këtë përmbajtje:

“c) Policia Pyjore me degët e saj rajonale.”.

3. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Strukturat dhe organikat e shërbimit pyjor, ato menaxhuese dhe të Policisë Pyjore miratohen me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e ministrit .”.

#### Neni 4

Neni 8 shfuqizohet.

#### Neni 5

Në nenin 13 shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Pyjet janë edhe objekt i sekuestrimit të karbonit. Ministria është organi përgjegjës për zbatimin e dispozitave të Protokollit të Kiotos. Karboni i sekuestruar llogaritet dhe tregtohet, sipas rregullave dhe procedurave të parashikuara në Protokollin e Kiotos, ku Republika e Shqipërisë është palë.”.

#### Neni 6

Në nenin 15, pas pikës 4 shtohet pika 5 me këtë përmbajtje:

“5. Kuotat e karbonit, në procesin e sekuestrimit të tij, u përkasin pronarëve, sipas pronësisë që kanë mbi fondin pyjor.”.

#### Neni 7

Në nenin 17 pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Pjesë të fondit pyjor kombëtar, që kërkohen nga subjekte juridike ose fizike apo nga organet e qeverisjes vendore, për t’u kthyer në truall, për zgjerimin e vijës kufizuese të ndërtimit dhe të shtrirjes territoriale të periferisë së qytetit dhe të qendrave të banuara në zonat rurale, për ndërtimin e strukturave turistike, të qendrave të pushimit apo shëndetësore, ose për qëllime të tjera publike, për rrugë automobilistike apo hekurudhore, për shpim dhe shfrytëzim të puseve të naftës e të gazit, për veprimtari minerare e gjeologjike, për aeroporte dhe struktura të telekomunikacionit, për qëllime të strukturave ushtarake e qendrave industriale, si dhe për qëllime bujqësore, hiqen nga fondi pyjor dhe nga Kadastra Kombëtare e Pyjeve, si më poshtë:

- a) pyjet dhe tokat me bimësi pyjore, me sipërfaqe deri në 1 ha, me miratimin e ministrit;
- b) pyjet dhe tokat me bimësi pyjore, me sipërfaqe mbi 1 ha e deri në 100 ha, me vendim të Këshillit të Ministrave;
- c) pyjet dhe tokat me bimësi pyjore, me sipërfaqe mbi 100 ha, me ligj të veçantë.”

#### Neni 8

Në nenin 19 pikat 1, 2 e 3 ndryshohen si më poshtë:

“1. Pjesë të fondit pyjor kombëtar dhe të pyjeve e tokave pyjore mund të jepen në përdorim për punë kërkimore e studimore, për mbarështim të florës dhe faunës së egër e për gjueti, për baza didaktike apo eksperimentale, për qëllime pushimi, argëtimi, shëndetësore, shoqërore dhe për veprimtari turistike.

Pjesë jopyjore të fondit pyjor kombëtar mund të jepen në përdorim për veprimtari biznesi dhe për kryerjen e operacioneve hidrokarbure, gjeologjike e minerare, për gurore e kariera, pa cenuar vlerat dhe funksionet e tyre.

Organet e shërbimit pyjor miratojnë, në fondin pyjor publik, vendet ose sheshet, ku mund të ushtrohen këto veprimtari, para se ato të licencohen, të pajisen me leje mjedisore e të miratohet ndërtimi i tyre nga KRRT-të.

2. Plotësimi i nevojave të banorëve të komunave me lëndë dhe dru zjarri, për sigurimin e bazës ushqimore për blegtorinë e për kullotje, si dhe për grumbullimin e prodhimeve drusore e jodrusore bëhet nga pyjet komunale. Për komunat, që nuk kanë pyje komunale, këto nevoja mund të plotësohen nga pyjet shtetërore, sipas rregullave dhe procedurave të udhëzimit, të miratuar nga

Këshilli i Ministrave.

3. Dhënia në përdorim e pjesëve të fondit pyjor publik bëhet në bazë të kontratave, të nënshkruara nga drejtori i drejtorisë rajonale të shërbimit pyjor, pasi është marrë më parë miratimi i ministrit. Kontratat përfundojnë në çastin kur KRRTRSH-ja miraton, për sipërfaqen e fondit pyjor, objekt kontrate, studime urbanistike. Rregullat, procedurat e kërimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor kombëtar caktohen me udhëzim të ministrit.”.

#### Neni 9

Në nenin 23 pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Administrimi dhe zhvillimi i pyjeve vendore apo i pjesëve të tyre bëhen nga njësitë e qeverisjes vendore, sipas planeve të mbarështimit dhe të dispozitave të këtij ligji.”.

#### Neni 10

Në nenin 26 bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

1. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Personat fizikë dhe juridikë mund ta trajtojnë dhe shfrytëzojnë fondin pyjor kombëtar vetëm me lejen përkatëse, të lëshuar në përputhje me dispozitat e këtij ligji. Kushtet dhe kriteret për dhënien e lejes për trajtimin dhe shfrytëzimin e fondit pyjor kombëtar përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Të drejtat, që sigurohen nga leja e trajtimit dhe shfrytëzimit të fondit pyjor kombëtar, nuk mund t’u transferohen apo t’u jepen të tretëve.

Subjektet, që pajisen me leje, mund të ndërtojnë ose të vendosin instalime të përkohshme, sipas skemave teknologjike, të miratuara nga drejtoria përkatëse e shërbimit pyjor.”.

2. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Materiali drusor, që shfrytëzohet çdo vit nga fondi pyjor kombëtar, caktohet brenda mundësive vjetore të trajtimit dhe shfrytëzimit të pyjeve, të përcaktuara në planet e mbarështimit, ndërsa në pyjet, me funksion mbrojtës e të veçantë, lejohet vetëm në rastet kur kryhen punimet e përkujdesjes dhe të prerjeve sanitare.”.

3. Pika 4 ndryshohet si më poshtë:

“4. Shfrytëzimi i ngastrave dhe i nënngastrave lejohet vetëm kur kërkohet teknikisht, në rastet e prerjeve farore, dritësuese, përfundimtare apo prerjet në pyjet e dëmtuara nga katastrofat natyrore apo zjarret, nën kontrollin e organeve të shërbimit pyjor.”.

4. Pas pikës 14 shtohen pikat 15 e 16 me këtë përmbajtje:

“15. Kur subjekti privat i specializuar kërkon të ndërtojë, me shpenzimet e veta, rrugën, për shfrytëzimin e ngastrave e të nënngastrave pa rrugë autopsyjore, drejtoria përkatëse pyjore kompenson shpenzimet për ndërtimin e rrugës, duke bërë korrektimin e tarifave bazë, në varësi të investimeve të kryera për m<sup>3</sup> lëndë drusore në këmbë. Në këto raste, subjekti gëzon të drejtën e shfrytëzimit të tyre deri në prerjet përfundimtare, të përcaktuara në planet e mbarështimit.

16. Kur subjekti privat i specializuar kërkon të marrë sipërfaqe të gjëra nga fondi pyjor, për afate të gjata kohore për të rehabilituar pyjet, kërkesa shqyrtohet, në mbështetje të dispozitave të ligjit nr. 9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet.”.

#### Neni 11

Neni 27 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 27

1. Shitja e materialit drusor në pyjet publike bëhet nga organet e shërbimit pyjor, me ankand, në dy mënyra:

a) në formën e asortimenteve të gatshme, në anë të rrugës ose në sheshet e depozitimit;

b) në këmbë (të paprera).

2. Ankandet për shitjen e asortimenteve të gatshme në anë të rrugës, të prodhuara nga subjektet private, për llogari të shërbimit pyjor, zhvillohen vetëm për pyjet e reja kur trajtohen me prerje kulturore, me rallime, të tipit I e II, si dhe për zonat e mbrojtura, në varësi të nevojave të trajtimit të ngastrave e nënngastrave pyjore, të fondeve të planifikuara për këtë qëllim dhe të kërkesave të tregut.

3. Shfrytëzimi dhe prodhimi i asortimenteve të gatshme dhe magazinimi i tyre në anë të rrugës apo në sheshe depozitimi realizohen nga subjekte private, të përzgjedhura, nëpërmjet tenderave, të organizuara nga organet e shërbimit pyjor, në përputhje me rregullat dhe procedurat e legjislationit në fuqi. Tenderat zhvillohen për ngastrat dhe nënngastrat, për të cilat janë përgatitur projektet tekniko-ekonomike të trajtimit apo të shfrytëzimit dhe vetëm në rastet kur garantohen efektiviteti ekonomik, miradministrimi dhe ruajtja e asortimenteve deri në shitjen e tyre.

4. Ankandet për shitjen e lëndës drusore në këmbë zhvillohen për pyjet e larta trungishte, pyjet e ulëta cungishte, si dhe për shkurret, që kanë arritur moshën e shfrytëzueshmërisë, sipas fazave të prerjes, të përcaktuara në planet e mbarështimit.

5. Këshilli i Ministrave cakton kriteret dhe rregullat e shfrytëzimit të pyjeve dhe të shitjes me ankand të materialit drusor e të prodhimeve të tjera, pyjore e jopyjore.

6. Materialet drusore dhe çdo prodhim tjetër me origjinë pyjore, të sekuestruara në qendrat e përpunimit apo në sheshet e depozitimit dhe të tregtimit, ruhen nga subjektet, të cilave u janë sekuestruar, deri në shitjen e tyre nga organet e shërbimit pyjor.

7. Materiali drusor, i përpunuar ose i papërpunuar, si dhe prodhimet e tjera pyjore e jopyjore transportohen nga pikat e grumbullimit dhe qendrat e përpunimit, deri në destinacionin përfundimtar, të shoqëruara me lejen e transportit, të lëshuar nga organet e shërbimit pyjor ose nga pronari privat, të nënshkruar nga organi përkatës i shërbimit pyjor, e cila vërteton prodhimin e tyre në përputhje me dispozitat e këtij ligji. Modeli i lejes së transportit miratohet nga ministri.”.

Neni 12

Pas nenit 27 shtohet kreu VI/I me këtë përmbajtje:

## **“KREU VI/I MONITORIMI DHE TË DHËNAT**

Neni 27/1

### **Monitorimi i pyjeve**

Monitorimi i pyjeve, që përfshin monitorimin e treguesve cilësorë dhe sasiorë të tyre, të biodiversitetit në pyje, të dukurive natyrore dhe të ndotjes e të dëmtimit të tyre, është proces i përhershëm dhe i detyrueshëm.

Neni 27/2

### **Programi i monitorimit**

1. Në bashkëpunim me organet qendrore dhe vendore, me Fakultetin e Shkencave Pyjore e me shoqatat e përdoruesve të pyjeve, ministria harton programin e monitorimit të pyjeve, si dhe bashkërendon e kontrollon punën për zbatimin e tij. Ministri miraton programin e monitorimit.

2. Programi i monitorimit të pyjeve përcakton treguesit e cilësisë së pyjeve, të biodiversitetit, të zhvillimit të ndotjes dhe dëmtimit, të dukurive natyrore, mënyrat e matjeve, të përpunimit të të dhënave, si dhe raportimin e botimin e tyre.

Neni 27/3

### **Sistemi i të dhënave**

1. Për të siguruar grumbullimin, përpunimin dhe botimin e të dhënave për pyjet, Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve, në bashkëpunim me strukturat menaxhuese të pyjeve, me Policinë Pyjore, me

qeverisjen vendore, me Fakultetin e Shkencave Pyjore e me shoqatat e përdoruesve të pyjeve, krijon sistemin e të dhënave, të domosdoshme për monitorimin e pyjeve.

2. Sistemi i të dhënave përmbledh tërësinë e treguesve shifrorë, të matshëm e të numërueshëm, që qartësojnë gjendjen e pyjeve dhe prirjet e proceseve që zhvillohen në to.

3. Në krijimin dhe përsosjen e sistemit të të dhënave, Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve synon përafrimin e plotë të tij me sistemet që përdor FAO-ja dhe që përcaktohen në direktivat e BE-së.

#### Neni 27/4

##### **Grumbullimi i të dhënave**

1. Të dhënat për monitorimin e pyjeve kërkohen, hartohen dhe paraqiten sipas rregullave të miratuara me udhëzim të ministrit. Personat fizikë e juridikë, publikë dhe privatë, paraqesin të dhënat brenda 30 ditëve nga marrja e kërkesës.

2. Të dhënat shoqërohen me shpjegime për interpretimin e tyre, me rekomandime për zgjidhjen e problemeve që dalin dhe dorëzohen në Agjencinë e Mjedisit dhe Pyjeve, në përputhje me formatin që ajo kërkon.

3. Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve kontrollon cilësinë e monitorimit, të matjeve, zbatimin e metodikave, kualifikimin e specialistëve që marrin pjesë, pajisjet e përdorura dhe vërtetësinë e rezultateve.

#### Neni 27/5

##### **Informimi dhe botimi i të dhënave**

1. Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve përpunon dhe dërgon për botim të dhënat dhe rezultatet që dalin prej tyre, në media dhe shtyp, në një formë të kuptueshme për publikun.

2. Në bazë të të dhënave dhe të rezultateve të monitorimit, Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve, në bashkëpunim me strukturat menaxhuese, harton dhe boton raportin vjetor për gjendjen e pyjeve. Përpunimi dhe botimi i të dhënave për vitin pararendës bëhen brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës.

3. Publiku dhe organizatat jofitimprurëse informohen për gjendjen e pyjeve, nëpërmjet botimit të të dhënave nga strukturat menaxhuese të pyjeve, nga Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve, nga organet e qeverisjes vendore, si dhe duke kërkuar të dhëna pranë këtyre organeve.

4. Rregullat dhe procedurat për informimin e botimin dhe shpërndarjen e të dhënave janë sipas legjislacionit në fuqi.

#### Neni 27/6

##### **Tërheqja në vendimmarrje**

1. Gjatë procesit të vendimmarrjes për pyjet, organet shtetërore, qendrore dhe vendore, sigurojnë pjesëmarrje dhe rol aktiv të komunitetit, të shoqatave të përdoruesve të pyjeve dhe të organizatave jofitimprurëse.

2. Ministri miraton rregullat e procedurat, që realizojnë pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrjet e strukturave menaxhuese.

#### Neni 27/7

##### **Shoqatat e përdoruesve të pyjeve**

1. Në procesin e zbatimit të këtij ligji, strukturat e menaxhimit të pyjeve dhe organet e qeverisjes vendore përfshijnë edhe shoqatat e përdoruesve të pyjeve.

2. Ministri përcakton rregullat dhe procedurat për përfshirjen e shoqatave, sidomos në hartimin, miratimin dhe zbatimin e:

a) strategjive, të planeve të veprimit dhe të programeve të zhvillimit të pyjeve;

b) planeve të mbarështimit e të programeve të monitorimit të pyjeve;

c) projektakteve normative për pyjet.

3. Përfaqësues të shoqatave të përdoruesve të pyjeve marrin pjesë në borde e komisione, që

krijohen për administrimin dhe mbrojtjen e pyjeve, në nivel vendor dhe qendror.

Neni 27/8  
**Lidhjet me biznesin**

Lidhjet me biznesin realizohen në rrugë institucionale, nëpërmjet dhomave të tregtisë dhe të industrisë, si dhe të organizatave profesionale të biznesit, të cilat paraqesin pikëpamjet e veta për hartimin dhe zbatimin e programeve të administrimit, të zhvillimit, të mbrojtjes e të shfrytëzimit të pyjeve.”.

Neni 13

Neni 38 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 38

1. Shkeljet e mëposhtme, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë si më poshtë:

a) prerja pa leje e pyjeve, e pyjeve të reja, e filizërisë dhe e fidanishteve, si dhe dëmtimi i tyre e i tokës pyjore, kur pasojat materiale janë të lehta, dënohet me gjobë 80 000 ( tetëdhjetë mijë) deri në 100 000 (njëqind mijë) lekë;

b) prerja e drurëve pa damkën e organeve të shërbimit pyjor, kur pasojat materiale janë të lehta, dënohet me gjobë 80 000 ( tetëdhjetë mijë) deri në 100 000 (njëqind mijë) lekë;

c) përdorimi i paligjshëm i fondit dhe i tokës pyjore dënohet me gjobë 80 000 (tetëdhjetë mijë) deri në 100 000 (njëqind mijë) lekë;

ç) prerja pa leje apo dëmtimi i pyjeve, në pronësi private, nga pronarët apo nga subjektet, të cilave u janë dhënë në përdorim ose me qira, kur pasojat materiale janë të lehta, dënohet me gjobë 30 000 (tridhjetë mijë) deri në 40 000 (dyzet mijë) lekë;

d) kullotja e bagëtive në pyjet e reja, në pyllëzime, në filizëri e fidanishte, në parcelat gjenetike e eksperimentale e në pyjet mbrojtëse, kur pasojat materiale janë të lehta, dënohet me gjobë 5 000 (pesë mijë) deri në 10 000 (dhjetë mijë) lekë;

dh) grumbullimi i prodhimeve pyjore e jopyjore, si rrëshirë, boçe, hala, gjethe, bar, lëgushë, humus, plisa, rrënjë e lëvore, lule, fruta, sytha e herbë, kërpudha, bimë mjekësore, eterovajore, tanifere, patavra, cungje, kucka, fashina, thupra, hunj, bandiera, zhuka e kallamishte, gurë, zhavorr e rërë, pa lejen përkatëse të organit të shërbimit pyjor, dënohet me gjobë 5 000 ( pesë mijë) deri në 10 000 (dhjetë mijë) lekë;

e) nxjerrja e rrënjëve të shqopës, bushit, maresë dhe prerja e thuprës së shëlgut e të llojeve të tjera të drurëve pyjorë, gjatë periudhës së vegjetacionit, dënohen me gjobë 20 000 (njëzet mijë) deri në 25 000 (njëzet e pesë mijë) lekë;

ë) krasitja për gjethe dhe kositja e grumbullimi i barit në fondin pyjor, pa lejen e organeve të shërbimit pyjor, dënohen me gjobë 8 000 (tetë mijë) deri në 10 000 (dhjetë mijë) lekë;

f) mbledhja e prodhimeve të dyta pyjore e jopyjore e bimëve mjekësore, eterovajore e tanifere, e bimëve të rralla e të kërcënuara e të tjera të kësaj natyre, jashtë periudhës teknike të vjeljes e me mënyra që sjellin degradimin, kërcënimin, rrallimin, zhdukjen apo dobësimin e funksioneve të tyre, dënohet me gjobë 80 000 (tetëdhjetë mijë) deri në 100 000 (njëqind mijë) lekë;

g) ndërhyrjet me punime të ndryshme në ligatinat dhe dunat bregdetare, pjesë përbërëse të fondit pyjor kombëtar, pa lejen e organeve të shërbimit pyjor, dënohen me gjobë 30 000 (tridhjetë mijë) deri në 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë;

gj) ndezja e zjarreve jashtë vendeve të caktuara nga organet e shërbimit pyjor dënohet me gjobë 7 000 (shtatë mijë) deri në 10 000 (dhjetë mijë) lekë;

h) prishja apo përdorimi i çekiç-damkës e i damkës nga persona të paautorizuar dhe nga një zonë pyjore në tjetrën, pa lejen e organeve të shërbimit pyjor, dënohen me gjobë 30 000 ( tridhjetë mijë) deri në 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë;

i) prishja, fshirja ose dëmtimi i shenjave kufidëftuese, gjeodezike e topografike, i tabelave paralajmëruese apo treguese, të vendosura në fondin pyjor kombëtar, dënohen me gjobë 15 000

(pesëmbëdhjetë mijë) deri në 20 000 (njëzet mijë) lekë;

j) ndërtimi i furrave të gëlqeres dhe i kaminave të qymyrit të drurit në fondin pyjor, pa miratimin e organeve të shërbimit pyjor, dënohet me gjobë 7 000 (shtatë mijë) deri në 10 000 (dhjetë mijë) lekë;

k) ngritja e ndërtimeve të thjeshta, gardhimeve, kampingjeve, brenda territoreve të gardhuara të fondit pyjor dhe të atyre të deklaruar me funksion mbrojtës e të veçantë, në kundërshtim me rregullat e përcaktuara në këtë ligj, dënohet me gjobë 20 000 (njëzet mijë) deri në 30 000 (tridhjetë mijë) lekë;

l) hedhja e mbetjeve urbane dhe e inerteve brenda në pyll ose në tokën pyjore dhe jashtë vendeve të caktuara, kur pasojat materiale janë të lehta, dënohet me gjobë 30 000 (tridhjetë mijë) deri në 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë;

ll) parkimi i automjeteve, vendosja e rulotave në pyjet me funksion mbrojtës e të veçantë, në parqet kombëtare, në rezervatet e mbarështimit të florës e të faunës së egër, në fidanishtet pyjore ose në vendet e tjera të fondit pyjor, me rëndësi të veçantë, pa miratimin e organeve të shërbimit pyjor, dënohen me gjobë 3 000 (tre mijë) deri në 5 000 (pesë mijë) lekë;

m) ndryshimi i zërit kadastral apo i kulturave pyjore nga pronari privat, pa miratimin e organeve të shërbimit pyjor, dënohet me gjobë 7 000 (shtatë mijë) deri në 10 000 (dhjetë mijë) lekë;

n) mosraportimi nga pronari i ndryshimeve përkatëse në fondin pyjor dhe në tokën pyjore, brenda 6 muajve nga data e vënies re, dënohet me gjobë 3 000 (tre mijë) deri në 5 000 (pesë mijë) lekë;

nj) transferimi i të drejtave, të siguruara nga leja e ushtrimit të veprimtarisë në fondin pyjor kombëtar, dënohet me gjobë 80 000 (tetëdhjetë mijë) deri në 100 000 (njëqind mijë) lekë;

o) transporti me kamionë i materialit drusor nga pylli dhe prej shesheve të depozitimit për në qendrat e përpunimit e të shitjes, i pashoqëruar me lejen tip të transportit, dënohet me gjobë 80 000 (tetëdhjetë mijë) deri në 100 000 (njëqind mijë) lekë;

p) mosruajtja e materialit drusor dhe e çdo prodhimi tjetër, me origjinë pyjore, të sekuestruar, i cili ndodhet në qendrat e përpunimit apo në sheshet e depozitimit e të tregtimit, nga subjektet, të cilave u është sekuestruar, deri në shitjen e tyre, dënohet me gjobë 8 000 (tetë mijë) deri në 10 000 (dhjetë mijë) lekë;

q) tregtimi ose tjetërsimi i materialeve drusore dhe i prodhimeve të tjera, pyjore e jopyjore të fondit pyjor kombëtar, pa lejen e organeve të shërbimit pyjor, dënohet me gjobë 80 000 (tetëdhjetë mijë) deri në 100 000 (njëqind mijë) lekë;

r) tregtimi i materialit drusor dhe i prodhimeve të tjera të pyllit, të infektuara nga sëmundjet, barërat e këqija e parazitare ose të prekura nga insektet, dënohet me gjobë 30 000 (tridhjetë mijë) deri në 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë.

2. Kur shkeljet e këtij ligji kanë sjellë pasoja të rënda, Policia Pyjore bën kallëzim penal. Kriteret për ndarjen e shkeljeve me pasoja të lehta apo me pasoja të rënda caktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

#### Neni 14

Pas nenit 40 shtohen nenet 40/1, 40/2 e 40/3 me këtë përmbajtje:

##### “Neni 40/1

##### **Vlerësimi i dëmit**

1. Për çdo rast të kryerjes së kundërvajtjes administrative apo të veprës penale në pyje, vlerësohet edhe dëmi që është shkaktuar dhe kërkohet shpërblimi i tij nga personi përgjegjës.

2. Kriteret dhe mënyra e caktimit të vlerës së dëmit të shkaktuar miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

##### Neni 40/2

##### **Likuidimi i gjobës**

Gjobat për kundërvajtjet administrative, të vëna në përputhje me këtë ligj, shlyhen brenda 30

ditëve nga data që vendimi ka marrë formën e prerë. Pas këtij afati, gjoba vilet nga organet e përmbarimit.

Neni 40/3

#### **Lidhja e kontratës**

Personat juridikë e fizikë, që kanë bërë instalime, ndërtime dhe ushtrojnë veprimtari në fondin pyjor publik, pa lidhur kontrata me drejtorinë përkatëse të shërbimit pyjor, duhet t'i lidhin ato brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Pas këtij afati, Policia Pyjore bën mbylljen e përhershme të veprimtarive dhe çmontimin e instalimeve.”.

Neni 15

Neni 42 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 42

#### **Aktet nënligjore**

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 7 pika 4, 9 pika 3, 17 pika 1 shkronja “b” e pika 2, 19 pika 2, 20 pika 9, 21 pika 8, 23 pika 7, 26 pikat 2, 8 e 10, 27 pika 5, 38 pika 2 dhe 40/1 pika 2.

2. Ngarkohet ministri të nxjerrë urdhrat dhe udhëzimet në zbatim të neneve 5 pika 6, 8 pika 2, 16 pikat 5 e 8, 17 pika 1 shkronja “a”, 19 pika 3, 20 pika 12, 25 pika 2, 26 pika 11, 27 pika 7, 27/2 pika 1, 27/4 pika 1, 27/5 pika 4, 27/6 pika 2 dhe 27/7 pika 2.”.

Neni 16

#### **Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5446, datë 31.7.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bamir Topi**

**Abonimet vjetore mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 267 468**  
**Çmimi i abonimit për Fletoret Zyrtare 2007 është 16 000 lekë.**

## **BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE**

|                                                                             |             |
|-----------------------------------------------------------------------------|-------------|
| <b>1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË</b>                                           |             |
| <b>2. KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR</b>                                   |             |
| <b>3. REGJISTRAT E NOTERISË</b>                                             |             |
| <b>4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI:</b>                                        |             |
| i. PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllimi i I-rë dhe vëllimi i II-të-2006)..... | <b>1300</b> |
| ii. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT.....                      | <b>500</b>  |
| iii. PËRMBLEDHJE MARRËVESHJESH NDËRKOMBËTARE NË FUSHËN E DREJTËSISË.....    | <b>1000</b> |
| iv. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR PUSHTETIN VENDOR.....                     | <b>800</b>  |
| v. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NDËRTIMET.....                             | <b>500</b>  |
| vi. PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË (2000-2006).....  | <b>1000</b> |
| vii. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SHOQËRITË TREGTARE.....                  | <b>500</b>  |

## **TREGUES LEGJISLACIONI**

|                                                                       |             |
|-----------------------------------------------------------------------|-------------|
| <b>1 TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I).....</b>  | <b>1000</b> |
| <b>2 TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II).....</b> | <b>500</b>  |
| <b>3 TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I).....</b>      | <b>1000</b> |
| <b>4 TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II).....</b>     | <b>500</b>  |

Hyri në shtyp më 3.8.2007  
Doli nga shtypi më 6.8.2007

|                    |                  |
|--------------------|------------------|
| Tirazhi: 3500 copë | Formati: 61x86/8 |
|--------------------|------------------|

Shtypshkronja "Nënë Tereza"  
Tiranë, 2007

Çmimi 32 lekë